



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 01.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.09.2024 të parashtruar nga "Marisa" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sanimi dhe ndërtimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes – Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- 632-24-9636-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Marisa" Sh.p.k., e dt.27.09.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sanimi dhe ndërtimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes – Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- 632-24-9636-5-2-1, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 16.09.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Korrigjohet** pjesërisht DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 16.09.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korrigjimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Marisa" SH.P.K., me dt.27.09.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sanimi dhe ndërtimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes – Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- 632-24-9636-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 01.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë pjesërisht të bazuara dhe autoriteti kontraktues do të bëjë korigjimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

